

DREJTËSIA SOT

**Analizë nga DREJTËSIA SOT (Qershor
2019 – Dhjetor 2019)**

**LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË
PARAVE DHE KONFISKIMI I
ASETEVE TË FITUARA NË MËNYRË
TË KUNDËRLGJSHME: Një
reflektim i gjendjes aktuale**



DREJTËSIA SOT



Analizë nga DREJTËSIA SOT (Qershor 2019 – Dhjetor 2019)

LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE KONFISKIMI I ASETEVE TË FITUARA NË MËNYRË TË KUNDËRLGJSHME: Një reflektim i gjendjes aktuale

Projekti “Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk i reflekton qëndrimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe.

LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE KONFISKIMI I ASETVE TË FITUARA NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME: Një reflektim i gjendjes aktuale

Contents

METODOLOGJIA	4
I. HYRJE	5
II. BAZA LIGJORE PËR NDJEKJEN E VEPRËS PENALE “SHPËRLARJE E PARAVE” DHE BAZA LIGJORE PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME	7
Baza ligjore për ngritjen e aktakuzës lidhur me veprën “Shpërlarja e parave” si vepër e vetme penale dhe si rrjedhojë e një aktiviteti tjetër kriminal	7
Baza ligjore mbi të cilën gjykata mund të konfiskojë pasurinë e fituar me vepër penale	8
III. TË GJETURAT E ANALIZIMIT TË NËNTË RASTEVE TË “SHPËRLARJES SË PARAVE” NË KOSOVË ...	9
IV. PËRFUNDIME	12
V. REKOMANDIME	13

METODOLOGJIA

Kjo analizë është e bazuar në të dhënat parësore nga monitorimi sistematik i rasteve të pastrimit të parave në tërë territorin e Republikës së Kosovës gjatë muajve qershor – nëntor 2019 nga platforma “Drejtësia Sot”, e cila është platformë e krijuar përmes projektit “Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës”, që implementohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë. Rastet e përzgjedhura për këtë analizë janë nëntë (9) raste, të cilat bazuar në informatat e mbledhura nga gjykatat themelore në Kosovë dhe Gjykata e Apelit, janë raste aktive në të cilat aktakuzat përbëhen nga vepra penale e “Shpërlarjes së Parave”. Për më tepër, rastet e përzgjedhura janë përzgjedhur në atë formë që të analizohen dy mundësitë e akuzimit të një personi për pastrim parash, përmes trajtimit të veprës penale të “Shpërlarjes së parave” si vepër në vete dhe si vepër rrjedhojë e një vepre bazë. Janë gjithsejt pesë (5) raste që janë marrë si mostër për analizimin e situatës kur prokuroria ka ngritur aktakuzë ku vepra penale “Shpërlarja e parave” ka qenë rezultat i vepres tjetër penale. Ndërsa, katër (4) nga rastet tjera të trajtuara në këtë analizë paraqesin rastet kur prokuroria ka ngritur aktakuzë për veprën penale “Shpërlarja e parave” si vepër në vete.

Për të analizuar mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës (PSRK) së Kosovës dhe gjykatave, pëërveç dokumenteve zyrtare gjatë monitorimit 6 mujor, janë analizuar edhe dokumentet zyrtare publike të rasteve, të cilat janë hartuar edhe para periudhës së qershorit 2019, kur GLPS nuk ka monitoruar këto raste në formë sistematike. Këto dokumente përfshijnë: kallëzimet penale të paraqitura nga Policia e Kosovës, aktakuzat e ngritura nga prokurorët special dhe vendimet e gjykatave themelore të Kosovës dhe Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, bazuar në këto dokumente kemi ardhur deri tek të gjeturat e paraqitura në këtë analizë.

I. HYRJE

Në kuadër të kërkesave të vazhdueshme për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, BE-ja dhe faktorët tjerë ndërkombëtar kanë insistuar që sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor të ndërmarrin masat e duhura kundër pastrimit të parave, në veçanti ato të lidhura me implementimin efikas të kuadrit ligjor. Duke njohur faktin se lufta kundër pastrimit të parave dhe konfiskimit të aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme janë elemente kryesore në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, përkushtimi dhe fokusi i institucioneve relevante duhet të jetë në trajtimin sa më efikas të kësaj dukurie. Mungesa e konfiskimit të aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme, kryesisht përmes pastrimit të parave tregon mungesën e profesionalizmit gjatë trajtimit të këtyre rasteve nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PRSK) dhe gjykatave në Kosovë.

Sfera ligjore për luftimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme në Republikën e Kosovës është optimale dhe lehtë e zbatueshme, mirëpo implementimi i saj në praktikë ka ngecur në masë të madhe. Jokompetenca që e shoqëron trajtimin e kësaj dukurie vihet në pah gjatë ngritjes së aktakuzave nga ana e prokurorëve dhe marrjes së vendimeve përfundimtare nga ana e gjykatës. Kjo ngase prokuroria dështon në sekustrimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme dhe në paraqitjen e propozimit për konfiskimin e tyre, ndërsa gjykatat dështojnë në konfiskimin e këtyre aseteve me vendime përfundimtare. Rrjedhimisht, trajtimi jo i duhur i kësaj dukurie rezulton me dëme të shumta në jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës mirëpo edhe në ekonominë e vendit meqenëse kjo dukuri krijon hapësirë të mjaftueshme për zhvillim të korrupsionit dhe krimit të organizuar në një nivel shumë të lartë.

Shpërlarja e parave në kuptimin e përgjithshëm, nënkupton vënien apo bartjen e parave dhe pasurisë së fituar me aktivitete kriminale në rrjedhat financiare të ligjshme, që në të ardhmen të krijohet legalizimi fiktiv i tyre. Me legjislacionin vendor, figura e veprës penale “Shpërlarja e parave” është përcaktuar në dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, të miratuar nga Parlamenti i Kosovës, më datë 13.06.2016.¹ Rregullimi ekzistues ligjor në Kosovë konsiderohet të jetë i mjaftueshëm në sigurimin e bazës së konfiskimit të aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme mirëpo, fatkeqësisht i njejti rregullim nuk has në implementim të kënaqshëm në praktikë.

Për më tepër, PSRK, ndër të tjera, ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në veprën penale “Shpërlarja e parave”.² Një rregullim i tillë i cili koncentron kompetencën për hetimin e veprës së pastrimit të parave vetëm në PSRK, konsiderohet të ketë ndikuar në numrin dhe cilësinë e aktakuzave të ngritura deri më tani, marrë parasysh kompetencën ekskluzive të PSRK-së në ndjekjen e veprave të tjera penale dhe numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve në këtë zyrë. Kurse, Kuvendi i Republikës së Kosovës me Ligjin Nr. 06/L-054 për Gjykatat ka krijuar Departamentin Special brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit me kompetencë të gjykimit të të gjitha lëndëve të cilat bien nën kompetencën e PSRK-së.³ Dhe rrjedhimisht, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 23 prill 2019, ka miratuar Rregullorën 03/2019, në të cilën konkretizohet mënyra e funksionimit të

¹Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, 13.07.2012, Neni 308, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>;

²Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës*, 03.06.2008, Neni 5, paragrafi 5.1., <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2526>;

³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat*, 18.12.2008, Neni 18, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2700>;

Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit.⁴ Mirëpo, edhe pse ky department është në fillimin e punës së tij, mendohet që i njëjti do të jetë i mbingarkuar për shkak të ekskluzivitetit që i njëjti ka edhe në gjykimin e veprave tjera penale, pra të gjitha veprave që bien në kompetencë të PSRK-së.

Edhe pse, të gjitha këto veprime janë ndërmarrur me qëllimin e vetëm që të luftohen dukuria e korrupsionit dhe krimin të organizuar që mbretëron në Kosovë, ku ndër to përfshihet edhe luftimi i shpërlarjes apo pastrimit të parave dhe konfiskimi i aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme, rezultatet janë të pakënaqshme. Kjo ngase prokurorët dhe gjyqtarët që janë të angazhuar në këto dikastere nuk kanë trajnimin e duhur të trajtojnë këtë vepër penale dhe rrjedhimisht të njëjtit nuk janë të profilizuar ende në ndjekjen dhe gjykimin e kësaj veprë. Për më tepër, një gjë e tillë ka ndikuar që fillimisht të mendohet që kjo vepër do të duhej të jetë rezultat i një vepreje tjetër penale dhe nuk është trajtuar si vepër penale në vete. Fatmirësisht kjo praktikë ka filluar të ndryshoj dhe janë disa raste në të cilat kemi prokurorë të cilët kanë ngritur aktakuzë për veprën penale të shpërlarjes së parave si vepër në vete dhe jo si rrjedhojë e një vepreje tjetër penale.⁵ Njëkohësisht, fakti që ndjekja e kësaj veprë është kompetencë ekskluzive e PSRK-së konsiderohet të ketë ndikuar në numrin dhe cilësinë e këtyre rasteve, marrë parasysh që ky dikaster ka kompetencë ekskluzive të hetojë dhe shumë vepra të tjera penale të rëndësishme së lartë dhe i njëjti nuk ka kapacitete humane dhe infrastrukturë të i bëjë ballë gjithë kësaj pune.

Rrjedhimisht, për qëllimin e kësaj analize, janë analizuar gjithsejt nëntë (9) raste të cilat janë aktive në gjykatat e Kosovës dhe aktakuza përmban veprën penale “Shpërlarje e parave”.⁶ Vetëm gjashtë (6) prej tyre përmbajnë të gjitha elementet e aktakuzës kur bëhet fjalë për këtë lloj të veprës penale.⁷ Vetëm në njërin nga këto raste është përfunduar procedura gjyqësore në shkallë të parë ku është konfiskuar vlera prej nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet euro e tetëdhjetë e katër cent (946.820.84) euro.⁸ Mirëpo, meqenëse ky rast është në Gjykatën e Apelit, vendimi ende nuk ka marrë formë të prerë dhe rrjedhimisht shuma e parave mbetet ende e sekuestruar. Ndërsa, në rastin me numër PKR.nr. 623/2015, Gjykata Themelore e Prishtinës ka liruar dy të akuzuarit, vendim ky që është anuluar nga Gjykata e Apelit dhe lënda është kthyer në rigjykim. Ndërsa rastet tjera të analizuar në këtë raport janë ende duke u zhvilluar në shkallë të parë dhe ende nuk ka vendim përfundimtar nga ana e gjykatës.

Drejtesia Sot duke u bazuar në monitorimin sistematik të zhvillimeve procedurale dhe vendimeve të organeve gjegjëse për këto çështje penale, përmes kësaj analize synon të pasqyrojë në detaje përmbajtjen dhe mangësitë e rasteve të cilat janë evidentuara gjatë kësaj periudhe. Më saktësisht, kjo analizë trajton fazën e hetimit, përkatësisht mënyrën e ndjekjes penale që përfshinë atë se si ka filluar hetimi për këto raste, nëse aktakuzat e ngritura përmbajnë obligimet ligjore të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe trajtimin e këtyre lëndëve nëpër gjykatat në të cilat

⁴Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Rregullorja për organizimin dhe funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit*, 23.04.2019, https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/igsl/57641_Rregullore_Nr.03_2019_per_Organizimin_Funksionalizimin_Departamentit_Special_Kuader_Gjykates_Themelore_Prishtine_Gjykates_Apelit.pdf;

⁵Rastet: PKR.nr.66/2018, PS.nr.13/2019, PS.nr.32/2019 dhe PS.nr.37/2019;

⁶ Rastet: PS.nr.35/2019, PS.nr.37/2019, PS.nr.30/2019, PKR.nr.398/17, PS.nr.13/2019, PKR.nr.66/2018, PS.nr.32/2019, PS.nr.16/2019, PKR.nr.623/2015. Këto raste janë duke u monitoruar nga Drejtësia Sot që nga muaji qershor 2019. Po ashtu këto janë të dhënat zyrtare të marra nga të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.

⁷Rastet: PS.nr. 35/2019, PKR.nr. 398/17, PS.nr.13/2019, PKR.nr. 66/2018, PS.nr.32/2019, PS.nr.16/2019

⁸Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, Aktgjykimi PKR.nr. 623/15, i datës 30.11.2016.

gjenden në procedim. Poashtu, kjo analizë trajton edhe centralizimin e kompetencës për hetimin e këtyre rasteve në PSRK dhe faktin që vetëm Policia e Kosovës mund të ndërmarrë hapa hetues në këtë aspekt. Për më tepër, trajtohet mundësia e shpërndarjes së kësaj kompetence në nivel të prokurorive themelore dhe përfshirja e Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganës së Kosovës si agjenci me mundësi hetimi dhe bashkëpunimi me prokurorinë. Në fund, kjo analizë ofron dhe një set rekomandimesh përmes të cilave tentohet të përmirësohet situata e trajtimit të veprave të pastrimit të parave nga institucionet e drejtësisë në Kosovë.

II. BAZA LIGJORE PËR NDJEKJEN E VEPRËS PENALE “SHPËRLARJE E PARAVE” DHE BAZA LIGJORE PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME

Baza ligjore për ngritjen e aktakuzës lidhur me veprën “Shpërlarja e parave” si vepër e vetme penale dhe si rrjedhojë e një aktiviteti tjetër kriminal

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (tutje KPRK), me nenin 308 ka paraparë që: *“Kushdo që kryen vepër penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit”*. Në këtë mënyrë, KPRK-ja ka paraparë shpërlarjen e parave si vepër penale në territorin e Republikës së Kosovës mirëpo, për rregullimin e saj ka udhëzuar në ligj të veçantë i cili në detaje ofron rregullimin e ndjekjes së kësaj veprë, e që në këtë rast njihet si *lex specialis*. Ligji Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, me nenin 56 ka paraparë rrethanat në të cilat mund të konsumohet vepra penale e pastrimit të parave.

Paragrafi 1 i këtij neni mundëson ndjekjen penale për veprën e pastrimit të parave si rrjedhojë e një aktiviteti tjetër kriminal. Pra, një aktakuzë e zakonshme e mbështetur në këtë paragraph të këtij neni do të përmbante edhe një vepër tjetër penale si vepër bazë. Ndërsa, vepra penale e pastrimit të parave do të ishte vepër rrjedhojë e veprës së parë dhe si e tillë do të gjykohej.⁹

Në anën tjetër, paragrafi 3 i këtij neni mundëson ndjekjen penale të personave që konsiderohet që kanë kryer veprën penale të pastrimit të parave edhe në rastet kur personi nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për vepër të ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerr pasuria e fituar me anë të veprës penale; ose kur i njeiti person nuk është gjykuar në të njejtën procedurë edhe për veprën paraprijëse si dhe në rastet kur gjykatat e Kosovës nuk kanë juridiksion territorial mbi veprat e ndërlidhura penale prej të cilave është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale të pastrimit të parave.¹⁰ Me anë të këtij paragrafi, ligjvënësi ka krijuar mundësinë e ndjekjes penale të personave të cilët kanë konsumuar vetëm veprën penale të pastrimit të parave ose të paktën nuk është provuar që të njejtit kanë kryer një vepër tjetër penale. Pra, me anë të këtij neni PSRK-ja mund të ngrisë aktakuzë ndaj kujdo që ekziston dyshimi i bazuar mirë se i njeiti ka kryer pastrim parash dhe për këtë nuk ka nevojë që personi të jetë i dënuar për një vepër paraprijëse; nuk ka nevojë që personi të jetë gjykuar edhe për veprën paraprijëse në të njejtën procedurë penale ose që gjykatat e Kosovës të kenë juridiksion të gjykojnë dhe veprën paraprijëse. Pra, ai person mund të gjykohet ekskluzivisht për aktivitetin që ka zhvilluar në pastrimin e parave.

⁹Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, 15.06.2016, neni 56, par.1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>;

¹⁰Po aty, par.3

Rrjedhimisht, PSRK-ja ka dy mundësi për ndjekjen penale të kryersve të veprës së pastrimit të parave. Së pari, PSKR-ja mund të mbështetet në nenin 56, paragrafin 1 dhe 2 në ngritjen e aktakuzës ku përshihet një vepër paraprijëse e veprës së pastrimit të parave. Dhe, së dyti, PSRK-ja mund të mbështetet tek neni 56, paragrafi 3 në ngritjen e aktakuzës për veprën e pastrimit të parave si vepër bazë, pa pasur nevojë të ketë një vepër paraprijëse. Rrjedhimisht, mund të përfundohet që legjislacioni i Kosovës ofron mundësi të mjaftueshme për përndjekjen e kësaj vepre kriminale.

Baza ligjore mbi të cilën gjykata mund të konfiskojë pasurinë e fituar me vepër penale

Baza ligjore për konfiskimin e dobisë pasuror të fituar në mënyrë të kundërligjshme parashihet në KPRK dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje KPPRK). KPRK në mënyrë të qartë në nenin 96 paragrafi 1 ka përcaktuar se: *“Askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale”*. Kurse paragrafi 2 i këtij neni thotë se *“Dobia pasurore sipas paragrafit 1 të këtij neni konfiskohet nga gjykata e cila konstaton kryerjen e veprës penale, sipas kushteve të parapara me ligj”*. Pra sipas kësaj dispozite, gjykata është e obliguar që t'ia konfiskojë çdokujt dobinë pasurore që është rezultat i veprës penale. Ky konfiskim i fitimit pasuror mund të bëhet vetëm me aktgjykimin e plotfuqishëm me të cilën është konstatuar kryerja e veprës penale.

Poashtu në dispozitat e KPPRK-së, është paraparë që gjykata të urdhërojë konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, pasi që prokurori i shtetit përcakton në aktakuzë pasurinë e cila dyshohet të jetë fituar me aktivitet kriminal dhe se e njejta është vërtetuar nga gjykata se është fituar në këtë mënyrë. Në nenin 115, paragrafi 2 thuhet se: *“Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues urdhëron konfiskimin e përhershëm të sendeve në pajtim me ligjin, nëse prokurori i shtetit: a. Përcakton në aktakuzë ato sende, pasuri, prova apo para të cilat i nënshtrohen konfiskimit të përhershëm; b. Nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale; dhe c. Ligji lejon konfiskimin e tyre.”* Andaj sipas KPPRK-së konfiskimin e përhershëm të sendeve në procedurë penale e urdhëron gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues.

Mirëpo, për të urdhëruar konfiskimin e përhershëm, gjykatësit i nevojitet iniciativa e prokurorit të shtetit që nënkupton se prokurori i shtetit duhet të përcaktojë në aktakuzë sendet, pasurinë, provat apo paratë, të cilat i nënshtrohen konfiskimit të përhershëm. Poashtu, duhet që në shqyrtim gjyqësor të vërtetohet se gjësendet e sekuestruara përkohësisht, të cilat janë përcaktuar në aktakuzë, kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar nga vepra penale dhe duhet të ekzistojë baza ligjore për konfiskimin e tyre.

Në praktikën gjyqësore, përkatësisht në këto raste të analizuara, në tre prej tyre nuk është paraqitur propozim për konfiskim të pasurisë nga ana e organit ndjekës.¹¹ Nëse një gjë e tillë nuk ndryshon, dhe prokurori i rastit nuk paraqet asnjë propozim atëherë dhe gjykata është e kufizuar në marrjen e vendimit të saj. Kjo ngase prokuroria është organi i cili duhet të precizojë në aktakuzë ose përgjatë shqyrtimit gjyqësor se cilat janë asetet të cilat janë rezultat i pastrimit të parave dhe paraqesin objekt për konfiskim. Vetëm në këtë rast gjykata mund të marrë vendim për konfiskim të aseteve të përfituara në formë të kundërligjshme.

¹¹Rastet: PKR.nr.623/2015, PS.nr.30/2019. PS.nr.37/2019;

III. TË GJETURAT E ANALIZIMIT TË NËNTË RASTEVE TË “SHPËRLARJES SË PARAVE” NË KOSOVË

Në bazë të monitorimit sistematik të rasteve nga Drejtësia Sot si dhe analizimit të dokumenteve zyrtare publike të rasteve, të cilat janë hartuar edhe para periudhës së qershor 2019, kur GLPS nuk ka monitoruar këto raste në formë sistematike, mund të konkludojmë se ekzistojnë mangësi të mëdha në procedimin e tyre nga ana e sistemit prokurorial dhe gjyqësor. Fillimisht do të ndalemi tek mënyra e fillimit të hetimeve nga ana e Prokurorisë ngase gjatë monitorimit të rasteve është hasur në një rol tejet pasiv të këtij institucioni në ndjekjen e këtyre veprave penale.

Së pari, prej nëntë (9) rasteve, në shtatë (7) prej tyre, ky institucion hetimin e ka filluar pas pranimit të kallëzimit penal nga Policia e Kosovës.¹² Policia e Kosovës ka për obligim ligjor që të paraqesë kallëzim penal pavarësisht nëse për të janë bërë me dije apo kanë marrë vesh në ndonjë mënyrë tjetër. Por, edhe pse Policia e ka detyrim ligjor paraqitjen e kallëzimit penal, PSRK do të duhej të tregohej më aktive në ndjekjen e kësaj vepreje për arsye se sipas kompetencave kushtetuese dhe ligjore është organ ndjekës, dhe se e njejta obligohet që sipas detyrës zyrtare (ex officio) të fillojë hetime, e jo vetëm atëherë kur paraqitet kallëzimi penal nga ana e palëve.¹³ Sipas asaj që u cek më lart, PSRK-ja nuk ka luajtur rol aktiv në këtë drejtim që konsiderohet si neglizhencë në kryerjen e detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Ligjet e Republikës së Kosovës.

Për më tepër, fakti që mundësi për hetimin e këtyre rasteve përpos PSRK-së ka vetëm Policia e Kosovës dhe asnjë agjenci tjetër shtetërore ndikon direkt në numrin e ulët të rasteve të ndjekura dhe në cilësinë e ulët të tyre. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Dogana e Kosovës paraqesin dy agjenci shtetërore të cilat kanë ekspertizë të veçantë në fushën e tyre e cila konsiderohet që nëse do të shfrytëzohej në hetimin e këtyre rasteve, do të ndikonte në ngritjen e numrit dhe nivelit të aktakuzave dhe pastaj edhe në vendimet përfundimtare të gjykatave. Duhet theksuar se para rregullimit të fundit ligjor, të dy këto agjenci kanë ndarë këtë kompetencë dhe heqja e kësaj kompetence prej tyre konsiderohet që ka ndikuar negativisht në trajtimin institucional të kësaj vepre. Nëse të njetat përfshihen në hetimin e rasteve të pastrimit të parave, jo vetëm që do të kishim një numër më të madh të këtyre rasteve por njëkohësisht, cilësia e aktakuzave, provat e mbledhura dhe trajtimi i rasteve do të ishte në një nivel më të lartë profesional. Kjo ngaqë të gjitha këto agjenci ofrojnë ekspertizë përkatëse në fushën e tyre që do të ndihmonte në ndriqimin e rasteve të dyshimta të pastrimit të parave. Thënë ndryshe, meqenëse këto agjenci paraqesin kontaktin e parë në të shumtën e rasteve kur kemi të bëjmë me pastrim parash, prokuroria gjatë hetimit të rastit, ngritjes së aktakuzës dhe përfaqësimit të saj në gjykatë do të duhej të mbështetej dhe bazohej në të dhënat e siguruarra prej këtyre agjencive. Të njetat do të duhej të plotësonin prokurorinë me anë të ekspertizës së tyre në fusha të caktuara që jo domosdoshmërisht mund të jetë prezente tek prokurori përkatës apo edhe tek gjyqtarët e lëndës.

Së dyti, gjatë analizimit të këtyre rasteve është vërejtur niveli i ulët i konfiskimit të pasurisë së fituar me vepër penale “Shpërlarje e parave”. Këtu nuk mjafton që të analizohet puna e institucioneve gjegjëse për konfiskimin e pasurisë së fituar nga kjo vepër, por edhe pasurisë së fituar nga veprat tjera penale. Si indikacion i ngecjes në këtë aspekt është disproporcioni tejet i madh në mes të pasurisë së

¹² Kallëzimi penal për rastin PS.nr.35/2019, Kallëzimi penal për rastin PS.nr. 37/19, Kallëzimi penal për rastin PS.nr.30/19, Kallëzimi penal për rastin PKR.nr. 398/17, Kallëzimi penal për rastin PS.nr. 13/2019, Kallëzimi penal për rastin PKR.nr. 66/2019, Kallëzimi penal për rastin PS.nr. 16/2019, dhe Kallëzimi penal për rastin PKR.nr. 623/2015;

¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, 15.06.2008, neni 109, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> si dhe *Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës*, 03.06.2008, neni 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2526>;

sekuestuar dhe asaj të konfiskuar. Sipas raporteve të publikuara vlera totale e pasurisë së konfiskuar është rreth 3.8 milion euro, ndërsa mbi 150 milion euro është vlera e pasurisë së sekuestruar në Kosovë.¹⁴ Për të pasur më të qartë ecurinë se si duhet të vihet deri tek një vendim i gjykatës që urdhëron konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme, duhet kuptuar dallimin në mes të sekuestimit të përkohshëm dhe konfiskimit të përhershëm të pasurisë që dyshohet të jetë fituar me vepër penale. Sekuestrimi nënkupton marrjen e përkohshme të sendit apo pasurisë gjatë fazës së hetimit nga ana e prokurorisë, me vendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, në rastet e caktuar kur ka dyshim të bazuar mirë se ky send apo pasuri është e fituar me vepër penale, ndërsa konfiskimi paraqet marrjen e përhershme të sendeve apo pasurisë, në qoftëse pas zhvillimit të procedurës penale dhe ekzekutimit të sanksionit penal është vërtetuar se sendi apo pasuria është fituar me vepër penale. Pra, në të dy rastet kemi të bëjmë me marrjen e sendit, por, derisa te sekuestrimi kemi të bëjmë me marrjetë përkohshme të sendit, tek konfiskimi është fjala për marrje të përhershme të sendit me vendim të plotfuqishëm të Gjykatës. Prandaj, vetëm sekuestrimi i aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme nuk është i mjaftueshëm. Të njëjtat duhet të konfiskohen me vendim përfundimtar të gjykatës dhe pastaj të kalohen në buxhetin e shtetit. Pasuria e sekuestruar e cila nuk konfiskohet me vendim të gjykatës, kthehet tek personat e akuzuar. Për më tepër, meqenëse procedurat gjyqësore zgjasin dhe në shumë raste aseteve të konfiskuara mund edhe të u bie vlera në treg dhe të dëmtohen gjatë kohës sa janë të sekuestruara, lind problemi i kompenzimit të tyre. Kjo ngase mungesa e një vendimi për konfiskimin e tyre bën që sekuestrimi i tyre të ndërpritet dhe të njëjtat të kthehen tek pronarët. Dhe kur asetet e tilla janë dëmtuar, një situatë e tillë krijon mundësi për kompenzim të pronarit të asetit nga shteti i Kosovës i cili ka dështuar ta konfiskojë atë.

Prandaj është kruciale që prokurori i rastit në aktakuzën përmes të cilës akuzohet një person për pastrim parash, të identifikoi pasurinë ose asetet të cilat janë fituar nga vepra penale ose nga aktiviteti kriminal dhe të kërkojë që të njëjtat të konfiskohen. Mungesa e konfiskimit të mjeteve të përfituara nga pastrimi i parave e humb kuptimin e qëllimit të dënimit të personit i cili ka zhvilluar një aktivitet të tillë ose personit që ka përfitur nga kjo situatë. Vetëm dënimi i personit për vepër penale ose aktivitet kriminal pa konfiskuar pasurinë ose asetet që janë rezultat i asaj veprë ose aktiviteti kriminal nuk e përmbush qëllimin e dënimit të personit që akuzohet për pastrim parash. Mjetet e fituara në mënyrë të kundërligjshme nëse nuk konfiskohen atëherë të njëjtat mund të përdoren prapë për qëllimin e njëjtë dhe mund të mundësojnë zhvillimin e aktiviteteteve kriminale tjera.

Së treti, e gjetur tjetër e kësaj analize është shfrytëzimi i vetëm njëres nga mundësitë ligjore të akuzimit për pastrim të parave nga ana e prokurorisë. Në këtë aspekt, i referohemi lidhshmërisë së veprës penale “Shpërlarja e parave” me ndonjë aktivitet tjetër kriminal, ku shpërlarja e parave trajtohet si vepër rrjedhojë e një veprë tjetër penale. Në pesë (5) nga rastet e analizuara për këtë raport, prokuroria ka përfshirë me një aktakuzë disa vepra penale së bashku me shpërlarjen e parave, ashtu që shpërlarja e parave ka qenë rezultat i veprëve tjetër penale. Kjo vë në pah mënyrën se si është trajtuar shpërlarja e parave deri së fundi në Kosovë, më saktësisht deri në vitin 2018. Ligji e ofron mundësinë që një person të akuzohet për shpërlarje të parave si vepër kryesore dhe e lejon mundësinë që një person të akuzohet për shpërlarje të parave si rrjedhojë e një veprë tjetër penale si psh vepra penale

¹⁴Radio Evropa e Lirë, *Paratë nga konfiskimi i pasurisë mund t’u barten organeve të sigurisë dhe drejtësisë*, 15.11.2019, [https://www.evropaelire.org/a/konfiskim-pasuria-kosove-/30272239.html?fbclid=IëAR2vJT4TQRy3cm1LvqT-kjDiKDU9EqH1Czr9lrTëZcIy3ZXTU4K1_rëmp9c\);](https://www.evropaelire.org/a/konfiskim-pasuria-kosove-/30272239.html?fbclid=IëAR2vJT4TQRy3cm1LvqT-kjDiKDU9EqH1Czr9lrTëZcIy3ZXTU4K1_rëmp9c);)

e mashtrimit, etj.¹⁵ Ashtu siç u shpjegua më lartë, deri në vitin 2018 në Kosovë janë ngritur vetëm aktakuza që kanë trajtuar shpërlarjen e parave si rrjedhojë e një veprë tjetër penale. Vetëm katër (4) prej rasteve të analizuara kanë trajtuar këtë çështje si vepër penale e veçantë, raste të cilat janë trajtuar në dy vitet e fundit.¹⁶ Kjo praktikë tregon mungesën e interpretimit të duhur ligjor i cili ka mbretëruar në Kosovë dhe mungesën e profilizimit të prokurorëve të PSRK-së dhe gjyqatrëve për hetimin e shpërlarjes së parave si vepër e vetme penale dhe për trajtimin gjyqësor të saj, si e tillë. Duke pasur parasysh se shpërlarja e parave hyn në kategorinë e veprave penale të një rrezikshmërie të lartë krahasuar me vepra tjera të cilat bien në kompetencë të prokurorive themelore, PSRK-ja do të duhej të i shfrytëzoi të gjitha mundësitë ligjore që lejohen për hetimin e veprës penale të pastrimit të parave. Për më tepër, meqenëse ligji e mundëson që një person të akuzohet për pastrim parash të cilat mund të jenë rezultat i një aktiviteti kriminal, çdo vepër penale e cila mund të konsiderohet si krim ekonomik, përfshin në vete pastrimin e parave. Prandaj, çdo vepër penale e cila në vete gjeneron para dhe çdo vepër penale e cila involvon lëvizje të parave ose lëvizje të dyshimta duhet të konsiderohet si bazë e mjaftueshme për përfshirjen e veprës së pastrimit të parave në aktakuzë, gjë që ekziston deri në një masë të kënaqshme në Kosovë. Mirëpo, meqenëse kompetenca për hetimin e veprës së pastrimit të parave bie vetëm nën PSRK-në, mundësia që kjo vepër të përfshihet në të gjitha aktakuzat që kanë të bëjnë me çfarëdo krimi ekonomik, pa marrë parasysh vlerën monetare, është e kufizuar. Kjo ngase pastaj të gjitha çështjet që në vete kanë rezultat të mira materiale dhe përfitim të aseteve të kundërligjshme do të duhet të barteshin në PSRK, institucion ky i cili nuk ka kapacitete humane dhe as infrastrukturë që të trajtoj të gjitha këto raste.

Së katërti, gjatë analizimit të këtyre rasteve është vërejtur që në disa prej rasteve si në rastin *PS.nr. 35/2019, PSRK-ja ka ngritur aktakuzë vetëm një ditë pa kaluar afati ligjor për ngritje të aktakuzës ose pushim të hetimeve. Sipas dispozitave të KPPRK-së hetimi për kryerjen e veprës penale përfundon brenda dy viteve nga dita e ngritjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve me mundësi zgjatje edhe për gjashtë (6) muaj.*¹⁷ Nëse brenda dy viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi, hetimi menjëherë pushohet.¹⁸ Në çështjet penale që kanë të bëjnë me shpërlarje të parave, duke e ditur se kjo vepër dëmton rëndë vlerat shoqërore dhe publike, PSRK-ja duhet që t'i jap prioritet hetimit të kësaj veprë penale e jo aktakuza të ngritet në momentet e fundit ose pak ditë para kalimit të afatit të hetimeve. Mirëpo, meqenëse PSRK-ja për momentin ka vetëm katërmëdhjetë (14) prokurorë dhe e njehta ka kompetencë të hetoj disa vepra penale si krime lufte, aktet terroriste, krimet kundër njerëzimit, etj., konsiderohet që e njehta nuk ka kapacitet të mjaftueshëm human për ndjekjen e të gjitha këtyre krimeve. Njëkohësisht, mungesa e profilizimit ndikon rëndë në trajtimin e rasteve dhe në kohëzgjatjen e tyre. Kjo ngase mungesa e ekspertizës në kuptimin dhe hetimin e të gjitha krimeve ekonomike të cilat në të shumtën e rasteve janë domosdo të ndërlikuara dhe mungesa e kompetencës së agjencive shtetërore të specializuara si ATK dhe Dogana në Kosovë për hetim, ndikojnë direkt jo vetëm në numrin e ulët të rasteve të pastrimit të parave por njëkohësisht edhe në kualitetin e hetimeve, aktakuzave të ngritura dhe përfaqësimit të tyre në gjykatë. Prandaj, ngarkesa e lëndëve, mungesa e profilizimit të prokurorëve dhe kompetenca e gjerë në hetimin dhe ndjekjen e shumë veprave penale që konsiderohen të rënda me legjislacionin kosovar, ndikon që edhe performanca e kësaj prokurorie të mos jetë në nivelin e duhur.

¹⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizimit*, 15.06.2016, neni 56, par. 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>;

¹⁶ Rastet: *PKR.nr.66/2018, PS.nr.13/2019, PS.nr.32/2019 dhe PS.nr.37/2019*;

¹⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës*, 28.12.2012, neni 159, par. 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>;

¹⁸ *Po aty*, par. 1;

Së pesti, gjatë analizimit të vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me rastin PKR.nr.398/17 ku gjykata ka dhënë aktgjykim dënues dhe ka konfiskuar vlerën prej nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet euro e tetëdhjetë e katër cent (946.820.84) euro, të akuzuarit janë dënuar me dy vite burgim me kusht dhe dënim me gjobë në shumën pesë (5) mijë euro për secilin.¹⁹ Një vendim i tillë ka krijuar hapësirë që i njejtë të kundërshtohet në Gjykatën e Apelit për shkak të lartësisë së sanksionit penal ngaqë i njejtë paraqet dënim minimal dhe nuk është në përputhje me dispozitat ligjore. Kjo ngaqë marrë parasysh seriozitetin e veprës dhe përpjekjet që duhet bërë në luftimin e krimit të organizuar, një sanksioni i tillë nuk përkon me qëllimin e dënimit. Njëkohësisht, neni 56 i Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit specifikon që: “Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen vepër penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale”. Prandaj, dënimi i shqiptuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës nuk i përmbahet standartit të vendosur me ligj dhe i njejtë nuk përmbush qëllimin e dënimit që tentohet të arrihet. I njejtë paraqet dënim minimal karshi dëmit që është shkaktuar dhe që në vazhdimësi tentohet të shkaktohej.

Ndërsa, në rastin PKR.nr. 623/15²⁰ ku Gjykata Themelore ka liruar të akuzuarit nën pretendimin që nuk ka pasur prova të mjaftueshme me të cilat do të mbrohej fajësia e tyre, Gjykata e Apelit këtë rast e ka kthyer në rigjykim për shkak se në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë janë vërtetuar shkelje esenciale të ligjit penal dhe vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike. Sipas këtij vendimi, në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanojë shkeljet e gjetura nga Gjykata e Apelit, të administrojë të gjitha provat e propozuara, nga autoritetet zvicere të kërkojë informatë të saktë dhe precize lidhur me fitimin e njërit nga dëshmitarët, duke precizuar për çdo vit kalendarik fitimin që i njejtë ka pasur.²¹ Rrjedhimisht, me vendimin e Gjykatës së Apelit janë identifikuar shkelje të cilat mund të kenë ndikuar edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë si mungesa e administrimit të tërësishëm të provave si dhe bashëkpunimi ndërkombëtar, të dyja këto shumë të rëndësishme në zbardhjen e një rasti. Mbetet të shihet se si Gjykata Themelore në Prishtinë do të i adresojë këto të gjetura dhe si do të veprojnë gjatë rigjyimit të rastit.

IV. PËRFUNDIME

Sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor po përballen me progres të kufizuar në luftën e tyre kundër pastrimit të parave, përkundër infrastrukturës ligjore të mjaftueshme për luftimin e kësaj dukurie. Rezultatet e dobëta të konfiskimit të pasurisë vazhdojnë të jenë tregues i mungesë së vullnetit të këtyre institucioneve në ndjekjen penale dhe dënimin e akterëve të këtij aktiviteti. Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, përbën një nga shtyllat e luftimit të krimit të organizuar, por institucionet e drejtësisë në Kosovë kanë treguar rezultate minimale në këtë drejtim. Këto organe

¹⁹Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, Aktgjykimi PKR.nr.398/17, datë 28.03.2019;

²⁰Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, Aktgjykimi PKR.nr.623/15, datë 30.11.2016;

²¹Betimi për Drejtësi, Themelorja nuk e merr parasysh udhezimin e Apelit që të bëhet një hetim për dëshmitarin, gjykatësi e konsideron antiligjor, <https://betimiperdrejtesi.com/themelorja-nuk-e-merr-parasysh-udhezimin-e-apelit-qe-te-behet-nje-hetim-per-deshmitarin-gjykatasi-e-konsideron-antiligjor/>;

nuk duhet që të mjaftohen vetëm me ngritjen e aktakuzave dhe zhvillimin e procedurave gjyqësore formale, por përmbajtësisht të luftojnë këtë dukuri e që në veçanti shfaqet me veprime konkrete në konfiskimin e dobisë pasurore të paligjshme. Për më tepër, si faktor kyç i cili ndikon në procedurën e konfiskimit të aseteve të përfituara në mënyrë të kundërligjshme është edhe mungesa e propozimit për konfiskim në aktakuzë ose gjatë procedurës penale dhe mungesa e precizimit të aseteve të indentifikuara si pasojë e veprës penale. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në vendimin final të gjykatës lidhur me konfiskimin meqenëse, nëse nuk ka objekt të identifikuar për konfiskim, atëherë gjykata nuk mund të tejkalojë propozimin e prokurorit lidhur me asetet e përfituara në mënyrë të kundërligjshme.

Njëkohësisht, mungesa e bashkëpunimit ndërinstucional është faktor kyç në mënyrën e hetimit, nivelin e përpilimit të aktakuzës dhe përfaqësimit të saj në gjykatë nga ana e prokurorëve. Mirëpo, e njejta është prezente edhe në marrjen e vendimeve nga ana e gjykatave të cilat dështojnë në shumë raste si pasojë e mungesës së ekspertizës në trajtimin e rasteve konkrete të krimeve ekonomike të ndërlikuara. Njëkohësisht, kompetenca e limituar e hetimit tek vetëm një agjenci, si Policia e Kosovës dhe mospërfshirja ose moskompetenca e Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganave në ofrimin e ekspertizës dhe mbështetjes së institucioneve të drejtësisë në zbardhjen e këtyre krimeve vazhdon të ndikojë në cilësinë e trajtimit të rasteve mirëpo edhe në numrin e rasteve aktive në gjykata. Poashtu, mungesa e profilizimit të prokurorëve e gjyqtarëve në rastet e pastrimit të parave dhe mbingarkesa me hetimin e llojeve të ndryshme të veprave penale të rënda, ndikon direkt në performancën e prokurorëve dhe gjyqtarëve në trajtimin e këtyre lëndëve.

Prej rasteve të analizuara mund të konkludohet se vlera totale e pasurisë që dyshohet të jetë fituar me veprën penale “Shpërlarje e parave” është rreth 12 milion euro, të cilat mjete nëse vërtetohet se janë fituar me aktivitet kriminal do të ndikojnë në rritjen e buxhetit të Republikës së Kosovës nëse të njejtat arrijnë të konfiskohen. Prandaj, luftimi i dukurisë së pastrimit të parave nga ana e institucioneve të sistemit të drejtësisë në Kosovë është nevojë urgjente e cila do të rezultonte në një jetë më të mirë për qytetarët përmes një ekonomie të rregulluar dhe legale. Për më tepër, meqenëse asetet e konfiskuara përmes vendimeve përfundimtare të gjykatave kalojnë në buxhetin e Kosovës, një gjë e tillë do të mund të kontribonte në përmirësimin e shumë sferave të jetesës për qytetarët. Njëkohësisht, luftimi i kësaj dukurie do të zvogëlonte mundësinë e implikimit të qytetarëve të Kosovës në aktivitete kriminale dhe do të ulte në përgjithësi shkallën e krimit në vend.

V. REKOMANDIME

Duke parë ndërlikueshmërinë e rasteve dhe rrezikshmërinë e veprës penale “Shpërlarje e parave” e po ashtu edhe të kryersve, Drejtësia Sot ka përgaditur disa rekomandime për institucionet gjegjëse me qëllim që të evidentohen në mënyrë të saktë dhe në kohë kryersit, prejudhja dhe destinimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, e poashtu me qëllim që rastet aktive të cilat janë në procedim në gjykatat e Republikës së Kosovës të trajtohen sipas dispozitave ligjore.²²

- PSRK ftohet që në mënyrë më aktive të nisë hetime ex officio në drejtim të veprës penale “Shpërlarje të parave” dhe të mos bazohet vetëm në kallëzimet penal nga ana e Policisë së Kosovës.
- PSRK ftohet të konsultoj edhe raportet e të gjitha agjencive të tjera, si psh. Agjencia Kundër Korrupsion, të cilat mund të raportojnë raste me rrethana që implikojnë pastrim të parave.

²²Rastet: PS.nr. 35/2019, PS.nr.37/2019, PS.nr.30/2019, PKR.nr.398/17, PS.nr.13/2019, PKR.nr.66/2018, PS.nr.32/2019, PS.nr.16/2019, PKR.nr.623/2015;

- PSRK duhet të sekuestroj të gjitha asetet që dyshohet të jenë objekt i shpërlarjes së parave që nga momenti kur fillon hetimet në drejtim të veprës penale “Shpërlarje e parave”. Kjo ngaqë në momentin e sekuestrimit, sekuestrohen asetet dhe të njejtat nuk mund të përdoren dhe nuk mund të jenë objekt i ardhshëm i pastrimit të parave. Për më tepër, të njetat kur sekuestrohen bëjnë të mundshëm dhe konfiskimin e tyre.
- PSRK-ja duhet të shfrytëzoi në tërësi bazën ligjore që lejon ngritjen e aktakuzave për “Shpërlarje të parave” si vepër e vetme, pavarësisht se a është e lidhur me ndonjë vepër tjetër penale, dhe mundësinë që vepra penale e “Shpërlarjes së parave” të jetë rrjedhojë e një vepreje tjetër penale. Kështu, PSRK të shfrytëzoi në tërësi të gjithë bazën ligjore për përndjekjen e dukurisë së pastrimit të parave.
- PSRK-ja duhet që në çdo aktakuzë të ngritur të përmbajë edhe propozimin për konfiskim, pasi që kjo i lehtëson gjykatës që në momentin e përfundimit të procedurës penale të konfiskojë pasurinë e paligjshme. Dështimi i propozimit për konfiskim të aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme kufizon mundësinë e gjykatës në konfiskimin e atyre aseteve dhe njëkohësisht humb kuptimin e dënimit për shpërlarje parash.
- Departamenti Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë ftohet që të bëjnë konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale në momentin kur gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se e njejta ka prejardhje nga aktivitetet të ndryshme kriminale.
- Departamenti Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën e Apelit ftohen që të interpretojnë në mënyrë të drejtë *Ligjin Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit i cili ofron mundësinë që një person të akuzohet për shpërlarje të parave si vepër kryesore dhe e lejon mundësinë që një person të akuzohet për shpërlarje të parave si rrjedhojë e një vepre tjetër penale.*
- Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit ftohen të shqyrtojnë mundësinë që ose:
 - o Të rritet numri i prokurorëve special dhe gjyqtarëve që do të gjykojnë në Departamentin Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën e Apelit, dhe të bëhet profilizimi i tyre ashtu që të ndahen prokurorët dhe gjyqtarët që trajtojnë ekskluzivisht veprat e krimit ekonomik, ose,
 - o Të shprëndahet kompetenca e trajtimit të veprave të pastrimit të parave edhe në Prokuroritë dhe Gjykatat Themelore të Kosovës. Kjo të realizohet ashtu që të krijohen kritere në bazë të cilave rastet e pastrimit të parave që kanë të bëjnë me një vlerë të caktuar monetare dhe ndërlikueshmëri në zbardhjen e tyre të mbeten nën kompetencën e PSRK-së dhe Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit, ndërsa rastet më të lehta dhe sidomos ato që rrjedhin si rezultat i një aktiviteti kriminal ose vepre tjerë penale, të hetohen nga Prokuroritë Themelore. Në këtë mënyrë, numri i rasteve të hetuara dhe të gjykuara për pastrim parash do të rritej dhe rrjedhimisht do të rritej edhe cilësia në trajtimin e tyre.
- Kompetenca për hetimin e rasteve të pastrimit të parave bie vetëm mbi PSRK-në dhe Policinë e Kosovës ndërsa Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës nuk e kanë këtë kompetencë me rregullimin e fundit ligjor të këtyre institucioneve. Një rregullim i tillë duhet të modifikohet në mënyrë që agjencitë administrative të përfshihen dhe të ofrojnë ekspertizë profesionale dhe informata që mund të ndihmojnë autoritetet e hetimit penal që të identifikojnë më mirë subjektet dhe fajësinë e tyre. Kjo ngase të njejtat ndajnë ekspertizë të veçantë në fushën e tyre e cila do të ndikonte në ngritjen e nivelit të hetimit të këtyre rasteve, përfaqësimit të tyre në gjykatë dhe vendimet përfundimtare të gjykatave në këto raste.



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies
